

Përse pyjet janë të rëndësishëm dhe si mund të ndihmoni në ruajtjen e tyre?

Pyjet janë thelbësor për ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm. Nga pastrimi i ajrit të streha për jetën e egër, pyjet ofrojnë habitate jetësore për një numër të madh speciesh dhe luajnë një rol të rëndësishëm në rregullimin e klimës globale.

PYJET JANË TË DOMOSDOSHME PËR CILËSINË E AJRIT TONË




Cilësia e Ajrit: Pyjet veprojnë si filtra ajri natyror. Ata përthithin dioksidin e dëmshëm të karbonit nga atmosfera dhe çlirojnë oksigjen, i cili na mundëson frymëmarrjen. Saktësisht, pyjet prodhojnë 28% të oksigjenit që ne përthithim.



Biodiversiteti: Pyjet ofrojnë habitat për një gamë të larmishme të faunës dhe florës, duke ndihmuar në ruajtjen e ekosistemeve të shëndetshme.



Rregullimi i Klimës: Pyjet luajnë një rol kyç në zbutjen e ndryshimeve klimatike duke ruajtur karbonin dhe duke ndikuar në modelet lokale të motit.



Shtëpi për jetën e egër

Pyjet janë shtëpi për jetën e egër, nga insektet e deri te gjitarët e mëdhenj si ariu i murrmë (*Ursus arctos*), rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*) dhe shumë të tjerë. Këto lloje kanë nevojë për pyjet për të siguruar ushqimin dhe strehimin. Nëse pyjet do të zhdukeshin, do të zhdukeshin edhe habitatet e tyre, duke lënë shumë lloje pa një vend për të jetuar.

Roli jetik i pyjeve në ruajtjen e ujit

Pyjet luajnë një rol thelbësor në ruajtjen e cilësisë së ujit duke filtruar ujin e shiut, i cili më pas ushqen lumenjtë dhe liqenet. Si burime të rëndësishme të ujit të freskët, këto ekosisteme ujore janë jetike për mbijetesën e njerëzve, faunës dhe florës. Përveç kësaj, pyjet funksionojnë si rezervuarë natyrorë uji, duke përthithur rreshjet dhe ndihmuar në parandalimin e përmytjeve. Ky proces kontribuon në qarkullimin e qëndrueshëm të ujit në Tokë, duke nënvizuar rëndësinë e pazëvendësueshme të pyjeve për shëndetin e ekosistemeve dhe menaxhimin e burimeve ujore.

“Farmacia e natyrës”

Pyjet janë strehë për një gamë të gjerë bimësh me veti mjekësore, nga mjekësia tradicionale bimore deri te produktet farmaceutike moderne. Këto burime natyrore ofrojnë përfitime të rëndësishme për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzimit. Ruajtja e pyjeve jo vetëm që mbështet biodiversitetin, por edhe kontribuon në mbrojtjen e shëndetit tonë.

“
Një shoqëri është e arritur atëherë kur të moshuarit mbjellin pemë, nën hijen e të cilave nuk do të ulen kurrë!

Parandaloni zjarrin në pyje

Parandalimi i zjarrit është jetik për mbrojtjen e pyjeve. Është e rëndësishme të jemi të kujdesshëm gjatë aktiviteteve jashtë zonave të banuara, duke shmangur lënien e zjarreve të ndezur pa mbikëqyrje. Çdo shenjë zjarri duhet të raportohet menjëherë tek autoritetet lokale për të parandaluar katastrofat natyrore.

Ndikimi i infrastrukturës gri në pyje

Dëmet që shkaktojnë infrastrukturën gri si ndërtime pa leje dhe digat, në mjedisin natyror janë gjithnjë e më shqetësuese. Është thelbësore të mbështesim zhvillimin urban të qëndrueshëm, që minimizon këto ndikime dhe promovon alternativa më të mira për të ruajtur ekosistemet dhe habitatet natyrore.

Bëhuni pjesë e aksioneve të restaurimit të pyjeve

Angazhimi në aksionet e mbjelljeve, qoftë si vullnetarë apo duke mbështetur organizatat që punojnë për këtë qëllim, është një hap i rëndësishëm për të ruajtur dhe mbrojtur mjedisin dhe biodiversitetin.



SKANO KODIN QR PËR TË DHURUAR



Hapa të vegjël me impakt të madh

Shfrytëzimi i pasigurt i pyjeve përbën një nga kërcënimet më serioze për pyjet e Shqipërisë, duke çuar në humbjen e habitateve, erozionin e tokës dhe përkeqësimin e cilësisë së ujit. Kur pyjet shfrytëzohen pa respektuar rregullat, humbasim biodiversitetin e paçmuar dhe rrezikojmë dëme mjedisore afatgjata që ndikojnë në jetën e komuniteteve në të gjithë vendin.

Pyjet e Shqipërisë janë një element kyç i trashëgimisë natyrore të kombit tonë, dhe mbrojtja e tyre fillon nga çdo individ.

Inkurajoni çdo individ që takoni që të vlerësojë rëndësinë e pyjeve dhe të angazhohet në nisma konkrete për mbrojtjen e pyjeve në komunitetin tuaj.



Kjo fletëpalosje është prodhuar në kuadër të Nismës për Pyjet e Veriut: Restaurimi i Pyjeve në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri.

Ky projekt financohet nga

